



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit në kontekst të zbatimit të pikës I.3.11”*Trajnimit i zyrtarëve ligjorë për përdorimin e sistemit të hartimit të legjislacionit*” i Planit të veprimit 2022-2024, SRAP 2022-2027, financuar nga Instituti Kombëtar Demokratik-Kosovë/NDI dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për ligjërues/trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

Trajnimit i Trajnerëve për Sistemit e Hartimit të Legjislacionit LDS

Kandidatet duhen të kenë njohuri në Sistemit e Hartimit të Legjislacionit LDS dhe në përdorimin e tij, për të ushtruar funksionin e hartimit dhe harmonizimit të legjislacionit në mënyrë digjitale, respektivisht në LDS.

Qëllimi i programit të trajnimit është krijimi i grupit të trajnerëve profesionalë, të cilët do të mbajnë trajnime për përdorimin e Sistemit për Hartimin e Legjislacionit LDS në Republikën e Kosovës.

Programi do të përfshijë kombinim të trajnimit teorik dhe praktik për përdorim të LDS, seanca mbi shkathtësitë prezantuese, metodat dhe teknikat e trajnimit, menaxhimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive gjatë trajnimit. Përveç kësaj, gjatë programit kandidatët për trajnerë do të përfshihen në mësim praktik, duke u angazhuar drejtpërdrejt në hartimin e modeleve të sistemit legjislativ, që kryhen nga ministritë e linjës sipas planit vjetor të qeverisë. Në fund të procesit, trajnerët do të jenë në gjendje të mbajnë vetë trajnim të barasvlershëm për përdorimin e legjislacionit, duke përdorur programin dhe materialet e ofruara nga Projekti.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Trajnimi i Trajnerëve pritet të mbahet gjatë qershor të këtij viti. Ndërsa pjesëmarrja në përdorimin e sistemit për hartimin e legjislacionit, që kryhen nga ministritë e linjës, do të fillojë menjëherë pas përfundimit të trajnimit të trajnerëve dhe i njëjti pritet të zgjasë për disa muaj.

Vlerësimi i kandidatëve:

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë periudhës dhe pas përfundimit të trajnimit.

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimitimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës;
- Përvoja në trajnime;
- Elementet tjera të meritës (pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit, certifikatat letër rekomandimet njohja e gjuhëve te huaja etj.).

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Pjesëmarrësit e suksesshëm, do të angazhohen trajner sipas nevojave të programit të trajnimit për Përdorimin e Sistemit për Hartimin Legjislacionit në Republikën e Kosovës.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: 27.05.2024 deri me 10.06.2024.

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një **letër motivimi (deri në 250 fjalë)** në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: besart.mulaj@rks-gov.net, duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në CV tuaj mund të kërkohen për verifikim.